# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-436952**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/11/analiza-filip-cakuli-ullishtja-kombetare-e-pronesise-shqiptare/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 14:08:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 11 shtator 2026, 13:51:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 11 shtator 2026, 13:50:00 UTC → 11 shtator 2026, 13:52:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5d3744ac3402b0018a981d2417b9bb0de3589c8f81e1b92a3ea3f4019b1cb080` |
| TEKSTI | `3cc4212cf37fc2db709fa40c560927c84057d3dd37141432befaa5346f85feba` |
| PAMJA | `4ae7fe5f8740ec6d7a58b30396c3eb5d9824cbefed05db35fe671d47a9915f42` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `94a16d7fce2a366a24971c6aaa6c0a0f0598ce07d3a2cc492c1e70a1736bc72e` |
| E MËPARSHMJA | `0547cc73506e049e2ddfd6d2fe00920a3a60d3b3e3ba87e8e41d9c770b068f3f` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/94a16d7fce2a366a24971c6aaa6c0a0f0598ce07d3a2cc492c1e70a1736bc72e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare

11/09/2026 15:51

Nga Filip Çakuli

Në Shqipëri kemi zgjidhur më në fund problemin 35-vjeçar të pronave.

Jo me Kadastër.

Jo me gjykatë.

Jo me hartë.

Me ullinj!

Dy biznesmenë grinden për një tokë në Palasë. Njëri thotë: “Është e imja, e kam blerë.” Madje thotë se një pjesë e ka blerë dy herë. Tjetri paraqitet me dokumentet e veta dhe me projektin e vet.

Shteti, ndërkohë, është në mes.

Kadastra jep dokumente. AZHT shqyrton projekte. KKTU merr vendime. Investitori merr status strategjik. Arkitektët projektojnë. Marketingu shet vila. Ndërtuesit ndërtojnë.

Dhe në fund shteti pyet:

“Po toka e kujt është?”

Kjo është njësoj sikur noteri të të martojë dhe, pas dasmës, të thotë:

— Prisni pak, të kontrollojmë nëse nusja ishte e martuar!

Por Palasa ka edhe një mrekulli tjetër.

Dokumenti zyrtar për projektin “Delta Falaise” flet për afro 258 mijë metra katrorë, nga të cilat 26 mijë private dhe afro 232 mijë metra katrorë që pretendohet se janë pronë shtetërore.

Dokumenti zyrtar për projektin "Delta Palase" flet për afro 258 mijë metra katrorë, nga të cilat 26 mijë private dhe afro 232 mijë metra katrorë që pretendohet se janë pronë shtetërore.

Pra kemi privat, shtetëror, AMTP, certifikata, investitor strategjik, leje, aplikime, mbivendosje…

Mungon vetëm një gjë e vogël:

Të dimë e kujt është toka.

Pastaj biznesmenët konfliktohen.

Dhe këtu shteti shqiptar shfaqet si Zeusi në tragjeditë greke: zbret nga qielli dhe zgjidh dramën.

— Mjaft! Do ta shpronësojmë!

Shumë bukur.

Po kë do shpronësojmë?

Të parin?

Të dytin?

Të dy?

Dhe zgjidhja me ullishte është madhështore.

Më saktë, "Madhështia e marrëzisë", siç thoshte Erazmi i Roterdamit.

Në vend që të zbulojmë kush e ka pronën, e marrim pronën.

Në vend që të zbulojmë kush gaboi në Kadastër, mbjellim ullinj.

Në vend që të zbulojmë kush firmosi çfarë, prodhojmë vaj ulliri.

Vetëm një tabelë duhet në hyrje të parkut të ardhshëm:

"ULLISHTJA KOMBËTARE E PRONËSISË SHQIPTARE"

Poshtë saj: "Këtu prehen paqësisht dy AMTP, disa certifikata pronësie, disa projekte turistike dhe pyetja e përjetshme shqiptare: E KUJT ËSHTË TOKA?"

Dhe një tabelë më e vogël: "Ju lutemi, mos i prekni ullinjtë. Mund të dalë pronari."

Dhe, për të shmangur çdo keqkuptim, në hyrje mund të vendoset edhe një sportel shtetëror:

"Për të hyrë në ullishte, paraqisni dokumentin e pronësisë."

Nëse keni dy dokumente, kaloni te sporteli i dytë.

Nëse keni tre, merrni numër.

Nëse nuk keni asnjë, mos u shqetësoni: shteti do t'ju japë një projekt, një leje dhe një status strategjik.

Pastaj, kur të ndërtoni vilën, do t'ju pyesë:

— Shumë bukur. Po kush ju tha se toka ishte e juaja?

Dhe nëse përgjigjeni "Kadastra", do t'ju tregojnë ullirin më të afërt.

Sepse në Shqipëri prona nuk zgjidhet më me ligj.

Zgjidhet me fotosintezë.

Nuk pyesim dhe intetesohemi për thelbin, po për vogëlsira. Si ai burri që i tregon gruas nga spitali, se e kishte përplasur makina, me tre brinjë të thyera, këmbë e duar në allçi. Do kisha vdekur në rrugë, po qëlloi Lola me makinë dhe më solli në spital. Gruaja pyet, cila është Lola…

**Top Channel**

Opinion »
Republika popullore e protestës
09/09 18:58
Sa të interesuar janë adoleshentët shqiptarë për politikën?
09/09 17:12
Dorëheqja shakullimë e ministres Evis Sala
08/09 14:16
"Trajtimi i Mlladiçit në Serbi: Ironi e madhe, po, çudi jo!"
08/09 11:35
Kujt ka gjasa t'ia japin votën banorët e rritur të bashkive që do të zgjerohen
07/09 18:27
Reportazh/ Nga gjurmët e Rrugës Egnatia te varret monumentale të Selcës së Poshtme dhe letra e kolonelit francez, përse Podradeci po josh turistët
05/09 10:10
Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel
Video »
Top News-Hyjnesha e Butrintit kthehet në shtëpi, vepra shekullore tani mund të shihet nga vizitorët
Top Channel/ "Nuk e harrojmë kurrë 11 shtatorin"! Trump: Kjo është arseja pse luftojmë sot
Top News – 'Bota do shohë 11 Shtatorin e dytë'/ Kreu i MI5 ngre alarmin: Terrorizmi, kërcënim
Top Channel/ "Teli me gjemba ishte shfaqje e shëmtuar e kompanisë", Rama: S'do këtë më
Top Channel/ Dështon sërish konstituimi i Kuvendit, Kurti përplaset me opozitën
Top Channel/ Prostitucion në apartamente me qira, goditet në Tiranë veprimtaria kriminale
Kryesore
Deputetët e PS Braçe, Spiropali, Xhafaj edhe këtë të premte asnjë njoftim për angazhim në 'Praninë Besnike'
18:24
Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri
10:19
Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe shpallet zyrtarisht i zhdukur
11:38

Kriten tensionet për ishujt Falkland, presidenti i Argjentinës anulon vizitën në Mbretërinë e Bashkuar
09:28
Lëvizja surprizë e Dinamos, merr ish-lojtarin e Partizanit, firmos sot para derbit të nesërm
16:05
Më të lexuarat
Kryeministri Rama liron nga detyra ministrin e Brendshëm, Besfort Lamallari, Ervin Demo merr postin e tij
Prishet moti/ Rikthehen reshjet e shiut dhe shtrëngatat, si parashikohen temperaturat për fundjavën dhe ditët në vijim
Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri
Profil/ Zëvendëson Lamallarin si ministër i Brendshëm. Nga bashkia e Beratit në Pushtetin Vendor, kush është Ervin Demo
Administrativja zhbllokoi pagat, ironizon Rama: Shqiptarët do u falnin gjysëm rroge gjykatësve, po të kishin të njëjtin standard për hallet e tyre
Pas betimit si ministre, Spahiu ndan detyrat te Shëndetësia: Që nga nesër në orën 08:00 do hapet një zyrë për problemet e qytetarëve
Pas mbledhjes së qeverisë, ministrat zbardhin vendimet: 110 mln euro me Gjermaninë, 7 mijë apartamente dhe fond për energjinë
Detaje tronditëse nga vdekja e papritur e Mazonakis/ Pasi u 'ngeli në dorë', mjekët kërkonin në ChatGPT si ta rikthenin në jetë, i bënë edhe foto
Tensionet përshkallëzohen në Lindjen e Mesme, SHBA dërgon trupa në Arabinë Saudite për luftën kundër Houthive
Debati për makinën e re të Ramës, ministrja Ismaili: Është me qira, nevojë për sigurinë e kryeministrit



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.